

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5625
E shtunë, 10 nëntor 2018
çmimi 0.40 €

Haxhi Shala: Janë rreth
300 kërkesa të serbëve
për t'u bërë pjesë e FSK-së

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KANCELARJA E GJERMANISË, ANGELA MERKEL, I KA SHKRUAR LETËR
KRYEMINISTRIT RAMUSH HARADINAJ, NËPËRMJET SË CILËS KONFIRMON
PËRKRAHJEN PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË INTERPOL

Gjermania mbështet fuqishëm anëtarësimin e Kosovës në Interpol




Çështja e pranimit të Kosovës në Interpol do të jetë pjesë e agjendës së Asamblesë së Përgjithshme të kësaj organizate që do të mbahet në fund të këtij muaji në Dubai. Për këtë çështje kryeministri Ramush Haradinaj ka pranuar një letër nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, e cila e siguron Haradinajn se Kosova do ta ketë mbështetjen e saj për anëtarësim në Interpol. Kryeministri Haradinaj ka theksuar se mbështetja e Gjermanisë për anëtarësimin e Kosovës në Interpol vjen në një çast kyç për konsolidimin ndërkombëtar të vendit tonë

TAKIMI I TRETË I PRESIDENTIT TË
KOSOVËS ME ATË TË SERBISË NË
BRUKSEL KA NXITUR REAGIME TË
SHUMTA NË PRISHTINË

Opozita kërkon ndihmën e pozitës për ta ndalur presidentin

Subjektet politike opozitare e kanë kritikuar presidentin Hashim Thaçi për takimin e tretë në Bruksel me homologun e vet serb Aleksandar Vučić. Përfaqësuesit e LDK-së, të LV-së dhe të PSD-së kanë vlerësuar se presidenti i vendit nuk ka mandat të bisedojë me Serbinë. Ata i kanë ftuar edhe deputetët e pozitës që ta ndalin këtë format dialogu të presidentit dhe ta ndërtojnë një platformë dhe një ekip negociator për këtë proces



Palushi: S' do të ketë rritje të çmimeve nga kompania ime

AKTUALE

**DERI KUR VETËM
NE DO T'I
PROVOJMË DHE
PRANOJMË
ZGJIDHJET E
DHIMBSHME?! F. 12**



BEHXHET SH. SHALA - BAJGORA

**LISTA SERBE KUNDËRSHTON
TAKSËN, MBËSHTET RRËZIMIN
E QEVERISË F. 6**

**INSTITUCIONET PREMTOJNË
PËRKRAHJE MË TË MADHE
PËR RININË F. 6**

EKONOMI



**LIMAJ: ME LEHTË ËSHTË TË
SHKOSH NË KINË SESA NË
BOSNJË E HERCEGOVINË F. 8**

**KËRKOHEB BASHKËRENDIM
PËR PROJEKTIN ITS F. 8**

KULTURË

**KOSOVË ME KËMISHË TË
KUQE QË 2000 VJET F. 13**

Behram HOTI

SPORT

**LLAPI DHE DRITA, VEÇ PËR
FITORE NË 'ZAHIR PAJAZITI' F. 16**

**DY TË ARTA DHE NJË E
ARGJENDTË F. 16**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ministri Berisha takon Metën, flasin për procesin e tranzicionit të FSK-së

TIRANË, 9 NËNTOR - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Rrustem Berisha, është duke qëndruar për vizitë zyrtare në Shqipëri. Berisha ka zhvilluar takime të ndara me presidentin Ilir Meta dhe ministren e Mbrojtjes, Olta Xhaçka. Berisha e ka njohur presidentin Meta me procesin e tranzicionit të FSK-së, miratimin e tri ligjeve nga Kuvendi i Kosovës lidhur me këtë proces, transparencën e plotë të këtij procesi, bashkëpunimin me partnerët strategjikë dhe shtetet anëtare të NATO-s për për-

fundimin me sukses të procesit, i cili po zhvillohet me konsensus të plotë të faktorit të brendshëm politik në Kosovë. Gjatë qëndrimit në Tiranë, ministri i FSK-së është pritur në takim edhe nga ministrja shqiptare e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, me të cilën ka biseduar për bashkëpunimin e shkëlqyer ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë si dhe për marrëdhëniet e mirë dypalëshe ndërmjet Ministrisë për FSK dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.

Berisha e ka njoftuar Xhaçkën edhe me zhvillimet e fundit në MFSK dhe FSK, për arritjet dhe partneritetin e ndërtuar me shtetet mike, si dhe për avancimin e planit lidhur me misionin dhe detyrat e FSK-së, i njohur tashmë si procesi i tranzicionit të FSK-së. Ndërsa ministrja Xhaçka e ka siguruar Berishën se Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë do ta mbështesë fuqishëm Kosovën për ndërtimin e kapaciteteve të saj dhe për objektivat për integritet euroatlantike.



Rama ripropozon Lleshin, Meta nuk tërhiqet

Rama ripropozoi Sandër Lleshin për ministër të Brendshëm dhe këmbëngul në faktin se presidenti nuk mund ta refuzojë emërimin e një anëtari të Qeverisë. Por, Meta edhe është i bindur se ka vepruar drejt për mosdekretimin e Lleshit

TIRANË, 9 NËNTOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, firmosi të premtën kërkesën e re dërguar presidentit Ilir Meta përmes së cilës ai ripropozon gjeneralin Sandër Lleshi në postin e ministrit të Brendshëm. Kërkesa, siç shpjegon Rama përmes një statusi në "Twitter", është shoqëruar dhe me "një relacion të detajuar shpjegues, në funksion të dekretimit të ministrit të Brendshëm".

Gjatë emisionit "Real Story" të gazetarit Sokol Balla në televizionin "Vizion Plus", Rama tha se paraqitja e kërkesës për Lleshin synonte që "t'i japim presidentit mundësinë që ta krijojë bindjen e plotë e të rifutemi në binarët e Kushtetutës. Ky precedent nuk mund të krijohet dhe nuk ka pse të krijohet", tha kryeministri. Ai paralajmëroi se në ditët e ardhshme Qeveria do t'i drejtohet edhe Gjykatës Kushtetuese për një interpretim të kësaj çështje. Ndonëse kjo Gjykatë është jashtë funksionit,

kryeministri tha se në momentin që ajo do të plotësohet me anëtarë mund ta marrë në shqyrtim dhe të sqarojë njëherë e mirë edhe këtë aspekt. Qëndrimi i presidentit u shoqërua me polemika të shumta për shkak të faktit se Kushtetuta nuk ia njeh shprehimisht një kompetencë të tillë kreut të Shtetit. Gjatë fjalës së tij në parlament të hënën, Rama këmbënguli në faktin se presidenti nuk mund ta refuzojë emërimin e një anëtari të Qeverisë. Meta nuk ka dhënë asnjë shpjegim zyrtar mbi motivet që e shtynë ta kundërshtojë propozimin e kryeministrit. Ai edhe sot u shfaq i bindur se ka vepruar drejt, ndërsa u pyet nga gazetarët për motivet ligjore. "Për sa i takon anës ligjore, pa dashur të jap leksione për Kushtetutën, të gjithë amatorët, diletantët apo atyre që janë të njëanshëm, do t'i ftoja edhe një herë ta lexojnë Kushtetutën, kompetencat e presidentit dhe



se akt formal apo ceremonial është vetëm betimi te presidenti", u shpreh ai.

Kreu i Shtetit duket se iu përgjigj drejtpërdrejt kryeministrit kur shtoi se "të gjithë atyre, që mendojnë se dekretimi nuk është një akt substancial dhe individual, por formal dhe se presidenti ka

detyrë vetëm të firmosë një propozim në këtë rast, pasi në Kushtetutë nuk thuhet në mënyrë eksplicite që presidenti mund të kthejë mbrapsht një propozim, kam një pyetje tjetër: A mundet Parlamenti ta rrëzojë dekretin e presidentit për një ministër? Sepse edhe kjo nuk

është e shprehur në mënyrë eksplicite në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kështu që, më lini ta bëj detyrën time me përgjegjshmëri të plotë, si gjithmonë", u shpreh Meta, duke lënë kështu të kuptohet se, pavarësisht prej përpjekjes së re të kryeministrit, asgjë nuk pritet të ndryshojë.

Sandër Lleshi iu besua drejtimi i Ministrisë së Brendshme, ndonëse "de jure" vetëm në rolin e një zëvendësministri. Një situatë për të cilën, të enjten reagoi dhe Ambasada Amerikane. Përmes një deklarate ajo u shpreh se "një Ministri e Brendshme plotësisht funksionale është një element kyç për ta siguruar vazhdimësinë e përpjekjeve dhe rezultateve të deritanishme", në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në të njëjtën linjë ka qenë edhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Përmes një postimi në "Twitter", ambasadori Luigi Soreca theksoi se "një Ministri e Brendshme plotësisht funksionale, në gjendje të vazhdojë të luftojë me forcë kundër krimit të organizuar, është thelbësore për Shqipërinë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian".

Kuvendi i Maqedonisë nuk arriti t'ia marrë mandatin Gruevskit

SHKUP, 11 NËNTOR - Kuvendi i Maqedonisë nuk arriti t'ia marrë mandatin deputetit dhe ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, i dënuar me dy vjet burgim për shpërdorim të detyrës zyrtare. Për heqjen e mandatit votuan 58 deputetë, ndërsa kundër 29 deputetë të VMRO-së. Që t'i merrej mandati, duhej të

votonin 80 deputetë apo dy e treta e deputetëve.

Nisma ishte paraqitur në Komisionin për çështje të mandateve pas njoftimit që kishte marrë Kuvendi nga gjykatat për dënimin e Nikolla Gruevskit me dy vjet burgim. Shumica parlamentare kishte kërkuar marrjen e mandatit me

arsyetimin se "Nikolla Gruevski nuk është i denjë ta ushtrojë detyrën e deputetit". Por, kërkesën për marrjen e mandatit nga VMRO-DPMNE-ja e vlerësuan të motivuar politikisht. Gruevski të enjten duhej të paraqitej në burg, por kjo është shtyrë edhe për ndonjë ditë për

shkak të një kërkesë të re nga ana e tij për shtyrjen e vuajtjes së dënimit. Ish-kryeministri Nikolla Gruevski po gjykohet edhe për shpërdorime të tjera të detyrës zyrtare, për mashtrime zgjedhore, dhunë të porositur ndaj ish-drejtuësve të opozitës në një komunë të Shkupit, e keqpërdorime të tjera financiare.



Takimi i tretë i presidentëve të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel ka nxitur reagime të shumta në Prishtinë

Opozita kërkon ndihmën e pozitës për ta ndaluar presidentin

Subjektet politike opozitare e kanë kritikuar presidentin Hashim Thaçi për takimin e tretë në Bruksel me homologun e vet serb Aleksandar Vuçiq. Përfaqësuesit e LDK-së, të LV-së dhe të PSD-së kanë vlerësuar se presidenti i vendit nuk ka mandat të bisedojë me Serbinë. Ata i kanë ftuar edhe deputetët e pozitës që ta ndalin këtë format dialogu të presidentit dhe ta ndërtojnë një platformë dhe një ekip negociator për këtë proces

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË 9 NËNTOR - Takimi i presidentit Hashim Thaçi me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Bruksel, ka nxitur reagime të ashpra të opozitës në vend. Zyrtarët e kësaj të fundit kanë e kritikuar shefin e shtetit për takime të këtij niveli, duke thënë se presidenti po dialogon me Serbinë pa mandat. Sipas tyre, me këto bisedime po rrezikohet veriu i Kosovës.

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, u ka bërë thirrje AAK-së dhe Nismës për ta ndaluar në Kuvend presidentin Thaçi. "Askush nuk ka mandat të dialogojë për territorin e Kosovës, ndërkaq Thaçi nuk ka mandat as të zhvillojë dialog me Serbinë. Ai duhet të ndalet nga Kuvendi ose nga qytetarët kundër këtyre skemave për ta minuar shtetësinë e Kosovës. Një kryeministër i dobët politikisht, që merret vetëm me punë të brendshme për interesa të ngushta politike dhe me populizëm të dëmshëm për stabilitetin ekonomik dhe social të vendit, e ka sjellë Kosovën në pozitën më të keqe në marrëdhëniet me jashtë në dhjetë vjet si shtet i pavarur", ka shkruar Hoti në profilin e tij në "Facebook".

Ai ka treguar se për të arritur këtë qëllim opozita ka nevojë për ndihmën e AAK-së dhe Nismës. "Skena politike duhet të jetë e unifikuar në veprime, e jo vetëm në deklarime, për ta ndaluar Thaçin të hyjë në pazare për Kosovën. Opozita sot është e unifikuar në veprime. AAK-ja dhe Nisma duhet të tregojnë vendosmëri për ta ndaluar Thaçin përmes Kuvendit duke e mbështetur rezolutën e opozitës. Ndryshe qytetarët do ta ndalin atë përmes shprehjes së refuzimit masiv, por atëherë AAK-ja dhe Nisma do të bartin përgjegjësinë para qytetarëve njësoj sikurse PDK-ja", ka shkruar Hoti.

Edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka komentuar takimin në mes të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe atij të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, duke thënë në këto takime po bisedohet për ndarjen e veriut të vendit. "Mbrëmë në Bruksel u zhvillua takimi i tretë i Thaçit me Vuçiqin. Edhe ky takim pa mandat nga Kuvendi, pa platformë parimesh e pa ekip negociator. Nga një njeri pa legjitimitet e pa kredibilitet, pa kompetencë e pa autoritet. Plani i Serbisë për marrjen e veriut të Kosovës është lakmi shoviniste e admirim nostalgjik për Gjermaninë naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore. 75 vjet më vonë Serbia e do pjesën e Kosovës që ishte nën Gjermaninë e Hitlerit. Kolaboracionisti i saj shqiptar, kësaj radhe është president ynë. Por, shekulli është tjetër...", ka shkruar Kurti në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka kritikuar edhe kryeparlamentarin Veseli që nuk po e fut në rend të ditës në Kuvend shqyrtimin dhe vlerësimin e dialogut 2011-2017. "Sot, më 9 nëntor, janë bërë katër muaj prej se Qeveria na e sollë në Kuvend raportin mbi arritjet dhe sfidat për zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit. Mirëpo, kryetari i Kuvendit dhe veglat e tij në kryesi aty, nuk e dëshirojnë shqyrtimin dhe vlerësimin e dialogut 2011-2017, marrëveshjet e bëra dhe rezultatet e tyre. Që prej 9 korrikut 2018 ai nuk do që ta fusë në agjendë parlamentare e ta sjellë në seancë plenare këtë raport të Qeverisë. Ky kryeparlamentar është kolaboracionist i kolaboracionistit", ka shkruar ai.

Ndërsa kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Shpend Ahmeti, ka thënë se Kuvendi i Kosovës duhet urgjentisht të arrijë marrëveshje për këtë proces. Sipas Ahmetit, Kosova duhet ta draftojë platformën dhe ta mandatojë ekipin gjithëpërfshirës shtetëror



në këtë proces tepër sfidues e të rëndësishëm për Kosovën. "Takimi i tretë në mes të Thaçit dhe Vuçiqit është takimi i tretë pa mandat dhe pa platformë. Edhe ky takim ishte pa legjitimitet ligjor e politik. Për më shumë është takimi i tretë publik i Thaçit pa transparencë dhe raportim. Kuvendi i Kosovës urgjentisht duhet të arrijë marrëveshje për rrugën përpara. Kosova duhet ta draftojë platformën dhe ta mandatojë ekipin gjithëpërfshirës shtetëror në këtë proces tepër sfidues e të rëndësishëm për Kosovën. Në kohën kur Serbia po bëhet gjithnjë e më agresive, e Thaçi gjithnjë më jolegjitim e jotransparent, urgjentisht duhet ta vendosim procesin në binarë demokratikë e institucionalë. Takim të katërt të

tillë nuk duhet të ketë!", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Takimi i tretë i dy presidentëve, pa ndonjë rezultat

Takimi i tretë ndërmjet presidentit të Kosovës dhe Serbisë, Hashim Thaçi e Aleksandar Vuçiq, në Bruksel, ka përfunduar pa ndonjë rezultat. Pas takimit, i cili është mbajtur në mbrëmjen e të enjtes, presidenti serb Vuçiq ka thënë se nuk ka dialog me Kosovën dhe nuk do të vazhdojë përderisa nuk tërhiqet taksa e vendosur nga Qeveria e Kosovës prej 10 përqindësh ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.

Ai ka mohuar se në këtë takim është folur për shkëmbim terri-torësh në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Kurse presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë pas takimit se kishte një ballafaqim jo të lehtë me monologun e tij serb, duke u bërë thirrje të gjitha partive politike që t'i bashkohen atij në këtë proces të dialogut. Pas takimit edhe Zyra e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ka lëshuar një komunikatë për media, në të cilën thuhet se BE-ja pret që Prishtina dhe Beogradi ta shpejtojnë angazhimin e tyre të dialogut duke pasur parasysh lidhjen e drejtpërdrejtë që ka dialogu me normalizimin e raporteve ndërmjet tyre dhe perspektivës konkrete të aspiratave të tyre evropiane.

Lista Serbe kundërshton taksën, mbështet rrëzimin e Qeverisë

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Lista Serbe, parti e komunitetit serb në Kosovë, ka vlerësuar se taksa që ua kanë vënë autoritetet e Kosovës prodhimeve të importuara nga Serbia, kërcënon mbijetesën e serbëve në

Kosovë, duke rritur çmimet e ushqimeve bazë. "Veprimet tona në Kuvendin e Kosovës do të jenë si opozitë e plotë dhe ne do të mbështesim çdo propozim për ta rrëzuar Qeverinë për shkak të sjell-

jeve të saj karshi interesave tona dhe rajonit", thuhet në komunikatën e Listës Serbe. Lista Serbe ka njoftuar se nëse Qeveria e Kosovës nuk e tërheq vendimin e tillë, do të organizojë edhe protesta.

Të martën Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për vendosjen e taksës doganore 10 për qind mbi mallrat e importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Partitë opozitare në Kosovë tash e disa

muaj kanë përgatitur mocionin e votëbesimit ndaj Qeverisë së kryeministrit Ramush Haradinaj, mirëpo atyre u mungojnë edhe katër vota për ta arritur shumicën e nevojshme prej 61 deputetësh.

Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, i ka shkruar letër kryeministrit Ramush Haradinaj, nëpërmjet së cilës konfirmon për

Gjermania mbështet fuqishëm an



Çështja e pranimit të Kosovës në Interpol do të jetë pjesë e agjendës së Asamblesë së Përgjithshme të kësaj organizate që do të mbahet në fund të këtij muaji në Dubai. Për këtë çështje kryeministri Ramush Haradinaj ka pranuar një letër nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, e cila siguron Haradinajn se Kosova do ta ketë mbështetjen e saj për anëtarësim në Interpol. Kryeministri Haradinaj ka theksuar se mbështetja e Gjermanisë për anëtarësimin e Kosovës në Interpol vjen në një moment kyç për konsolidimin ndërkombëtar të vendit tonë

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Kryeministri Ramush Haradinaj ka pranuar një letër nga kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, e cila i ka konfirmuar kryeministrit përkrahjen e fuqishme të Gjermanisë për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. "Këtë e konfirmon letra nga kancelarja Angela Merkel, të cilën e pranova sot përmes ambasadorit

Christian Heldt. Mbështetja e fuqishme e Gjermanisë mike për anëtarësimin e Kosovës në Interpol vjen në një moment kyç për konsolidimin ndërkombëtar të vendit tonë. Kancelarja Merkel vë në pah se ky akt do ta fuqizojë integrimin e Republikës së Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare dhe është në shërbim të përmirësimit të bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe hetimit të krimin transnacional. Thellësisht mirën-

johës kancelares Merkel dhe shtetit gjerman për mbështetjen e vazhdueshme", ka shkruar Haradinaj.

Çështja e pranimit të Kosovës në Interpol do të jetë pjesë e agjendës së Asamblesë së Përgjithshme të kësaj organizate që do të mbahet në fund të këtij muaji në Dubai. Zyrtarët qeveritarë kanë bërë me dije se tashmë janë bërë të gjitha përgatitjet që Republika e Kosovës të bëhet anëtare e organizatës më të

madhe ndërkombëtare të policisë, Interpol.

Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Ekrem Mustafa, ka treguar se ka një angazhim të jashtëzakonshëm dhe të koordinuar mirë për pranimin e Kosovës në Interpol. "Ka një angazhim të jashtëzakonshëm dhe mirë të koordinuar ndërmjet ministrive, Policisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera. Janë angazhuar ekspertë të cilët me lobimin e tyre dhe argumentet që ofrojnë, po përmbysin pretendimet e ndryshme nga zëra të caktuar të cilët mund të kenë rezervë lidhur me pranimin e Kosovës në Interpol. Që nga ardhja ime në detyrë fillimisht jam informuar lidhur me angazhimet e të gjithë aktorëve relevantë të inkuadruar në lobimin për Interpol, më pas edhe jam inkuadruar në këto aktivitete së bashku me kabinetin tim", ka deklaruar për gazetën "Epoka e

re". Sipas ministrit Mustafa, janë dhënë garanci të forta nga shtete të ndryshme, se jo vetëm do ta japin votën e tyre pro anëtarësimin të Kosovës në Interpol, por do të shohin edhe mundësitë e lobimit tek anëtarët e tjerë. Ai ka theksuar se bashkëpunimi ndërmjet policive është garanci që në botë nuk do të lejohen 'vrime të zeza' në të cilat pamundësohet qasja e Interpolit. "Anëtarësimi në Interpol nuk është thjesht një hap tutje rreth rumbullakimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës por ai, para së gjithash, prek aspekte të sigurisë dhe të bashkëpunimit ndërshtetëror në këtë drejtim. Pjesë e menjëherëshme e agjendës sime janë kontaktet me përfaqësues ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe atashetë policore në kuadër të misionëve diplomatike në Kosovë. Janë dhënë garanci të forta nga shtete të ndryshme, se jo vetëm që do ta japin votën e

krahjen e saj për anëtarësimin e Kosovës në Interpol

ëtarësimin e Kosovës në Interpol



BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND
DIE BUNDESKANZLERIN

Berlin, 31. Oktober 2018

Seiner Exzellenz
dem Ministerpräsidenten
der Republik Kosovo
Herrn Ramush Haradinaj
Pristina

Sehr geehrter Herr Ministerpräsident, *liube kwr Haradinaj*,

vielen Dank für Ihr Schreiben vom 1. Oktober 2018, in dem Sie die kosovarische Absicht unterstreichen, Mitglied von Interpol zu werden.

Deutschland unterstützt dieses Anliegen nachdrücklich. Es würde die Integration der Republik Kosovo in die internationale Gemeinschaft stärken und unsere Sicherheitszusammenarbeit weiter verbessern. Es wäre zudem ein bedeutsamer Schritt, um Bemühungen zur Strafverfolgung auf internationaler Ebene mehr Nachdruck zu verleihen.

Sie können sich daher auf unsere Unterstützung bei Ihrer Kampagne verlassen.

Mit freundlichen Grüßen

Angela Merkel

Përktim

REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË
KANCELARJA FEDERALE

Berlin, më 31 tetor 2018

Shkëlqesisë së Tij
Kryeministrit të
Republikës së Kosovës
Zotit Ramush Haradinaj

Shumë i nderuari zoti Kryeministër, i dashur zoti Haradinaj,

Ju faleminderit shumë për shkresën Tuaj të datës 1 tetor 2018 në të cilën Ju e nënvizoni synimin e Kosovës për t'u bërë anëtare e Interpolit.

Gjermania e mbështet fuqishëm këtë çështje. Një gjë e tillë do të fuqizonte integrimin e Republikës së Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare dhe do të përmirësonte edhe më bashkëpunimin tonë në fushën e sigurisë. Për më tepër do të ishte ky një hap i rëndësishëm për të theksuar edhe më shumë përpjekjet për hetimet e krimin në nivel ndërkombëtar.

Për këtë arsye Ju sigurojmë mbështetjen tonë gjatë kampanjës Tuaj.

Me nderime

(d.v.) Angela Merkel

tyre pro anëtarësimin në Interpol, por do t'i shohin edhe mundësitë e lobimit ndër anëtarë të tjerë. Bashkëpunimi ndërmjet policive është garanci që në botë nuk do të lejohen 'vrime të zeza' në të cilat pamundësohet qasja e Interpolit. Secili shtet anëtar në Interpol nuk duhet ta shikojë anëtarësimin vetëm si obligim karshi sigurisë ndërkombëtare, por edhe t'i trajtojë qartë përfitimet dhe përparësitë që krijohen për sigurinë kombëtare dhe për sundimin e rendit dhe ligjit brenda shtetit.

Njohësi i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Republika e Kosovës është në pozicion të vështirë por, sipas tij, këtë herë ka gjasa më të mëdha për anëtarësim në Interpol. Megjithëse në këtë drejtim ofensiva e diplomacisë serbe është mjaft e fuqishme, Qehaja ka thënë se këtë herë Kosova do të ketë

mundësi të anëtarësohet në organizatën më të madhe ndërkombëtare të policisë. "Mendoj se këtë herë janë bërë përgatitjet para-prake që të bëhet një lobim për Interpolin sepse anëtarësimi i Kosovës në këtë organizatë që ka të bëjë me sigurinë dhe me policinë ndërkombëtare ka një rëndësi të madhe. Unë shpresoj se këtë herë do të kemi mundësi të anëtarësohemi, megjithëse ofensiva e diplomacisë serbe në këtë

drejtim është një kundërvënie mjaft e fuqishme kundër asaj që ne jemi duke e bërë për anëtarësim. Ata i kanë marrë të gjitha detajet që ne i kemi sa iu përket përgatitjeve dhe dërgimit të njerëzve tanë për lobim jashtë. Kështu që është një pozicion bukur i vështirë por, sidoqoftë, mendoj se këtë herë gjasat për anëtarësim në Interpol janë shumë më të mëdha se në vitin e kaluar", është shprehur Qehaja.



NË NUMRIN E ARDHSHËM TË "EPOKËS SË RE" FLET VEPRIMTARI HASAN UKËHAXHAJ

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Në numrin e ardhshëm (të hënën) të gazetës "Epoka e re" do ta lexoni intervistën me profesorin dhe veprimtarin e çështjes kombëtare, Hasan Ukëhaxhaj. Në këtë intervistë ai flet për vitet e fëmijërisë dhe rinisë së vet, për punën prej profesori të gjuhës dhe letërsisë shqipe, për veprimtarinë politike në kuadrin e lëvizjes ilegale, për protestat e vitit '81, për bashkëpunimin me të ndjerin Adem Demaçi, për vuajtjen e dënimit me burg prej dhjetë vjetësh dhe për emërimin e tij zëvendësministër i Arsimit në Qeverinë e Përkohshme të udhëhequr atëkohë nga Hashim Thaçi.

- Si ishte fëmijëria e Hasan Ukëhaxhaj?
- Në cilin rast e kishte mësuar emrin e të ndjerit Adem Demaçi dhe pse Demaçi shkoi në odën e Hasan Ukëhaxhaj?
- Çfarë thotë Hasan Ukëhaxhaj për veprimtarinë e tij politike në kuadrin e lëvizjes ilegale?
- Cili ishte bashkëpunimi i tij me Ismajl Haradinajn?
- Kush ishin bashkëpunëtorët e tij të tjerë?
- Si i cilëson ai protestat e vitit '81?
- Çfarë thotë për vështirësitë në kazamatet e Jugosllavisë?
- Në cilin vit u lirua nga burgu Hasan Ukëhaxhaj dhe me çfarë filloi të merret?
- Cila ishte veprimtaria e Hasan Ukëhaxhaj pas largimit nga Kosova në Gjermani dhe aktiviteti i tij në kuadër të LPK-së?
- Për çfarë arsye në qershor të '99-s kishte ardhur në Kosovë, Hasan Ukëhaxhaj?
- Kush e emëroi zëvendësministër të Arsimit në Qeverinë e Përkohshme të drejtuar atëkohë nga Hashim Thaçi?
- Pse veç katër ditë e mbajti postin e zëvendësministrit të Arsimit?
- Çfarë kishte biseduar në atë kohë me kryeministrin Hashim Thaçi?
- Cili është kontributi i Hasan Ukëhaxhaj në fushën e kulturës në përgjithësi dhe çfarë do t'ju sjellë lexuesve në të ardhmen nga penda e tij?

Për të gjitha këto pyetje, përgjigjet e veprimtarit dhe profesorit Hasan Ukëhaxhaj mund t'i gjeni në intervistën e cila do të botohet në dy vazhdimet në gazetën "Epoka e re". Intervistën e ka realizuar Mal Qorraj.

Vetëvendosje: Mbështetja për ushtrinë është obligim yni

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Një delegacion i Lëvizjes Vetëvendosje ka vizituar të premten Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), me ç'rast ka thënë se me një ushtri të përgatitur e armatosur mirë, qytetarët e Kosovës do të kishin më shumë vetëbesim, më shumë siguri dhe më shumë shpresë për të ardhmen e vendit. Sipas LV-së,

ky takim ishte i nevojshëm pas kalimit të projektligjit për FSK-në për t'u parë se ku dhe si mund të ndihmohet më tutje.

Gjenerallejtënant Rrahman Rama e ka falënderuar Lëvizjen Vetëvendosje për mbështetjen dhënë votimit të projektligjit për FSK-në. Deputeti i LV-së, Xhelal Sveçla, ka treguar se në

Komisionin për Siguri po punon për disa ndryshime që të mos ketë pengesa në të ardhmen. Delegacioni i LV-së tha se mbështetja për ushtrinë është obligim yni. Po ashtu, gjatë takimit pati pajtueshmëri se çështja e zhvillimit dhe avancimit të FSK-së duhet prioritetuar në aspektin buxhetor.



Institucionet premtojnë përkrahje më të madhe për rininë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 NËNTOR - "Lansimi i programit që po ndodh sot, po e jep një kornizë të asaj se si do të ndodhin disa programe garuese, që krijojnë perspektivë të re për talentët", kështu ka thënë të premten kryeministri Ramush Haradinaj me rastin e promovimit të programit nacional për rininë.

Kryeministri Haradinaj me këtë rast, pasi ka përgëzuar koordinatoren nacional për kulturë, rini dhe sport për punën e mirë që ka bërë, ka thënë se arsyeja pse ky moment është ndryshe nga përditshmëria, është për faktin se

në vendet e tjera, njerëz të suksesshëm, karrierën e tyre e kanë filluar duke garuar dhe marrë bursë dhe shpërblyer nga shkolla, universiteti. "Nga këto gara mund të lindin liderë të ardhshëm të shkencës, të profesioneve të ndryshme", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se Qeveria që udhëheq ka marrë seriozisht përgjegjësitë e veta ndaj pasurisë më të madhe që ka vendi ynë, e që është rinia, femijet. "Kemi rritur për 12 për qind buxhetin për arsim. Është një rritje shumë përmbajtësore e këtij buxheti dhe në të njëjtën kohë i kemi trajtuar me kujdes obligimet ndaj arsimit edhe me

kryetarët e komunave", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke shtuar se lansimi i programit që po ndodh sot po e jep një kornizë të asaj se si do të ndodhin disa programe garuese që krijojnë perspektivë të re për talentët.

Haradinaj e ka vlerësuar të drejtë çështjen e rinisë sonë që të lëvizë lirshëm dhe të jetë pjesë e rinisë evropiane, duke potencuar se rinia e Kosovës nuk është më e pazot se rinia e vendeve të tjera dhe me këtë rast, lëvizja e lirë do të ishte nxitje që gara të hapej më shumë.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se ky projekt është imponant dhe në të

njëjtën kohë lë shumë për të arritur për shkak se ka të bëjë drejtpërdrejt me asetin themelor për të cilën, siç u shpreh ai, Republika e Kosovës është krenarë që i ka, e ajo është rinia e vendit. Veseli ka thënë se kjo rini aktualisht është duke u ballafaquar me sfida të cilat janë të natyrave të ndryshme qoftë në fushën e edukimit, qoftë në fushën e integritit, në sektorin e tregut të punës, por në të njëjtën kohë ballafaqohet edhe me vështirësi në aspektin regional dhe evropian, duke qenë rinia më e izoluar. "Tani në qeverisjen e kryeministrit Haradinaj kanë filluar hapat e parë që janë shumë shpresëdhënës për rininë dhe ky projekt tregon një mundësi për të

rinjtë dhe të rejtat tona, që t'i zhvillojnë aftësitë e veta dhe tregojnë se Qeveria e Kosovës mendon për ta dhe do t'i përkrahë ata", ka thënë Veseli.

Koordinatori i Qeverisë për kulturë, rini dhe sport, Rexhep Hoti, ka thënë se programi nacional për rininë shtrihet ekskluzivisht për nxënësit e shkollave fillore, të mesme të ulëta, të mesme të larta dhe studentë. Ai ka falënderuar për pjesëmarrje në këtë program dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë. Të pranishëm në promovimin e këtij programi ishin edhe kryetarë të komunave të Republikës së Kosovës, akademikë dhe ambasadorë të akredituar në vendin tonë.



Fillojnë përgatitjet për mbledhjen e dy qeverive

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, të premten ka pritur në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, me të cilin ka diskutuar për parapërgatitjet për mbledhjen e përbashkët të dy qeverive Kosovë - Shqipëri që do të mbahet më 26 nëntor në Komunën e Pejës. Ministri Matoshi dhe ambasadori Minxhozi kanë biseduar për përgatitjet

përfundimtare për shpalljen e malit të Pashtrikut si zonë e mbrojtur ndërkufitare Kosovë - Shqipëri dhe shndërrimin e tij në atraksion turistik. Shpallja e malit të Pashtrikut si zonë e mbrojtur është paraparë në Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

të Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 2017 me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, shëndetit dhe mirëqenien e qytetarëve të dy vendeve.

Gjatë këtij takimi ministri Matoshi dhe ambasadori Minxhozi kanë folur edhe për mundësinë e zhvillimit të Junikut dhe Tropojës si dhe për mundësinë e krijimit të fondeve për pastrimin e liqenit të Fierzës.



Thaçi: Pa ndërkombëtarët, Kosova nuk do të ishte atdhe i të gjithë qytetarëve

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Në Paris është promovuar të premten libri më i ri i cili i kushtohet Kosovës dhe presidentit Hashim Thaçi. Presidenti Thaçi, i cili ka marrë pjesë në përurimin e librit "Lindja e një demokracie", ka thënë se ky libër pasqyron sfidat nëpër të cilat ka kaluar Kosova. "Edhe një libër i ri për Kosovën, që pasqyron sfidat

nëpër të cilat kemi kaluar si popull, para dhe pas krijimit të shtetit tonë. 'Lindja e një demokracie' është libri i promovuar sot në Paris, i autorit Jacques Baudouin, me parathënie shkruar nga Bernard Kouchner, ku përshkruhen hollësisht ngjarje të rëndësishme të rrugëtimit tonë drejt pavarësisë. Vërtet kemi pasur çaste të vështira në

Kosovën e pasluftës me administratorin Kouchner, por e falënderoj shumë për kontributin e tij të madh. Pa mbështetjen e madhe ndërkombëtare, sot Kosova nuk do të ishte atdhe i të gjithë qytetarëve të të gjitha komuniteteve. Bashkë e kemi ndërtuar paqen, të cilën tash po e forcojmë!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



Në Qendrën Mediale në Çagllavicë Komisioni për Punë të Brendshme ka organizuar debat publik për pakon e Projektligjeve për transformimin e FSK-së në ushtri me pjesëtarët e komunitetit serb

Haxhi Shala: Janë rreth 300 kërkesa të serbëve për t'u bërë pjesë e FSK-së

Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Haxhi Shala, ka bërë me dije të premten se janë rreth 300 kërkesa të qytetarëve serbë për t'u bërë pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Ndërkaq deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, i cili është anëtar i këtij komisioni, ka thënë se ushtria e Kosovës nuk nënkupton luftë, por paqe



EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Deputetë të Kuvendit të Kosovës, anëtarë të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, kanë zhvilluar të premten debat publik në Qendrën Mediale në Çagllavicë në lidhje me pakon e Projektligjeve për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me pjesëtarët e komunitetit serb.

Kryetari i këtij komisioni, Haxhi Shala, ka ftuar qytetarët serbë të aplikojnë në Forcën e Sigurisë së Kosovës që të jenë pjesë e saj e të mos bien pre e kërcënimeve. Ai ka bërë me

dije se janë rreth 300 kërkesa të serbëve për t'u bërë pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. "Disa pjesëtarë serbë e kanë lëshuar FSK-në, por s'mund të themi se e kanë lëshuar me dëshirë. Por, tani ka kërkesa të shumta për t'u bërë pjesë e kësaj force. Janë rreth 300 kërkesa të qytetarëve serbë për t'u bërë pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ne nga komuniteti serb kemi kadetë të rinj dhe togerë", ka deklaruar Shala.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, i cili është anëtar i këtij komisioni, ka thënë se ushtria e Kosovës nuk nënkupton luftë, por paqe. "Ushtria bëhet jo për

të luftuar, por për ta mbrojtur integritetin territorial. Mos i shihni ushtrinë dhe luftën bashkë. Mos i shihni si diçka që do të bëjë luftë. As nuk do të jetë forcë agresore", ka thënë Selimi.

Ndërsa deputeti i PDK-së, anëtar i këtij komisioni, Fatmir Xhelili, e ka qartësuar një

deklaratë të kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se ushtria do të bëhet në muajin nëntor të këtij viti. "Krijimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës dëshiron kohë, ligjet janë vetëm fillimi i kompetencave të reja që veprojnë në korniza të Kushtetutës, së paku do të duhen 8 deri në 10 vjet që

të bëhet tamam ushtri, edhe pse do të quhet Forca e Sigurisë së Kosovës. Ne s'jemi duke folur për 500 mijë veta, por jemi duke folur për 5 000 veta që do të ndahen në njësi të ndryshme. Ky është një proces që vazhdon. Asgjë nuk do të ndodhë as në dhjetor dhe as në janar", ka thënë Xhelili.

BE-ja i kërkon Qeverisë së Kosovës t'i heqë detyrimet doganore

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Bashkimi Evropian (BE) pret nga autoritetet në Kosovë të ndërmarrin hapa drejt vazhimit të dialogut për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Kështu deklaruan për "Radion Evropa e Lirë" zyrtarët në Bruksel, pas paralamërimin të presidentit serb, Aleksandar Vuçiq, se nuk do të takohet me homologun Hashim Thaçi derisa të jetë në fuqi taksa që u ka vënë Kosova importeve nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Kjo thuhet të ketë

qenë edhe tema kryesore e takimit të dy presidentëve, të enjten në Bruksel, me ndërmjetësimin e shëfës së politikës së jashtme të BE-së, Federica Mogherini. Zëdhënësja e Mogherinit, Maja Kocijançiq, ka thënë se masa që ka ndërmarrë Kosova ndaj prodhimeve të Serbisë dhe Bosnjës minon bashkëpunimin rajonal dhe "nuk është në përputhje me parimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit". "E kemi bërë të qartë se vendimi i Qeverisë së Kosovës është shkelje

e detyrimeve të Kosovës që dalin nga CEFTA (Marrëveshja për Tregti të Lirë midis vendeve të Evropës Qendrore). Ne qartë presim që Kosova ta tërheqë këtë masë", ka thënë Kocijançiq. Të martën Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për vendosjen e taksës doganore mbi mallrat e importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Kjo masë nënkupton taksën prej 10 përqindësh në të gjitha importet me prejardhje nga Serbia dhe Bosnja.



Flet për "Epokën e re", Shaqir Palushi

Palushi: S'do të ketë rritje të çmimeve nga kompania ime



Pronari i "Frutex", Shaqir Palushi, i cili është një nga prodhuesit dhe eksportuesit më të mëdhenj duke filluar nga regjioni, Evropa dhe Azia, ka thënë se taksa e vendosur nga Qeveria e Kosovës për mallrat që vijnë nga Serbia dhe Bosnjë Hercegovina është vendim i duhur dhe i mirëseardhur për prodhuesit vendorë. Sipas tij, edhe pse mund të ketë kosto për biznesin e tij për shkak të importit të lëndës së parë, ai ka garantuar se kompania e tij nuk do t'i rrisë çmimet, duke theksuar se interesi i Kosovës është më i madh sesa i biznesit të tij

shumë më i madh sesa i kompanisë", u shpreh ai.

Palushi në këtë intervistë ka garantuar se, pavarësisht prej situatave që do të vijnë, biznesi i tij nuk do t'i rrisë çmimet e mallrave, por do të shikojë të gjejë alternativa për importime të lëndës së parë. "Ne jemi të gatshëm ta bartim këtë kosto, duke mos i rritur edhe çmimet në treg. Kjo masë duhet të merrej edhe më herët. Kompania ime nuk do t'i rrisë çmimet. Ne do t'i zvogëlojmë të hyrat tona dhe do të gjejmë alternativa të tjera", ka deklaruar Palushi.

Ai ka përmendur edhe sfidat që kanë pasur si eksportues për shtetet në fjalë. "Ne kemi eksporte në Bosnje dhe Serbi. Një gjë nuk ka qenë e pamundur, por me vështirësi. Mirëpo, prapëseprapë importi është më i madh. Ne kemi pasur telashe, pra nuk ka qenë e

pamundur, por jemi përballur me barriera të shumta për ta dërguar lëndën e parë në këto shtete, pasi produktet nga Kosova kalojnë me vështirësi. Për të eksportuar një produkt në Serbi së paku një herë në gjashtë muaj produktet tona duhet t'i dërgojmë në terminale në Serbi, t'i shkarkojmë në mënyrë që të qëndrojnë atje 10 deri në 12 ditë derisa të kryhen analizat", ka thënë ai.

Palushi ka apeluar te Bashkimi Evropian që mos të bëjë presion te Qeveria e Kosovës, por te pala serbe pasi, sipas tij, pala serbe i ka shkëlur marrëveshjet ekonomike. "Adresa e presioneve do të duhet të ishte Serbia nga ana e Bashkimit Evropian dhe jo Kosova, pasi prej vitesh ne përballemi me vështirësi të eksporteve të produkteve tona", ka thënë pronari i "Frutex", Shaqir Palushi.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Pronari i "Frutex", Shaqir Palushi, i cili është një nga prodhuesit dhe eksportuesit më të mëdhenj, duke filluar nga regjioni, Evropa dhe Azia, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se taksa e vendosur nga Qeveria e Kosovës për mallrat që vijnë nga Serbia dhe Bosnjë Hercegovina është vendim i duhur dhe i mirëseardhur për prodhuesit

vendorë. Sipas tij, edhe pse taksa prej 10 përqindësh është simbolike, është një indikacion që u është dhënë vendeve të rajonit, se edhe prodhuesit nga Kosova duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe mos të shkelen marrëveshjet e CEFTA-s dhe MSA-së. "Qeveria e Kosovës e ka marrë një vendim të domosdoshëm pasi që vendet e rajonit duhet ta kenë parasysh pozitën tonë dhe të na trajtojnë në mënyrë të barabartë", ka thënë Palushi. Ai

ka thënë se nga kjo taksë mund të kenë kosto prodhuesit vendorë për shkak të importimit të lëndës së parë mirëpo, pavarësisht prej kësaj, ai ka thënë se interesi i Kosovës është para interesit të biznesit të tij. "Edhe pse ne si biznes prodhues mund të prekemi nga çmimet, pasi importojmë lëndën e parë, interesi i Kosovës është më i madh sesa interesi im privat. Unë si prodhues vendor jam i gatshëm ta bart këtë kosto sepse interesi i Kosovës është

Limaj: Më lehtë është të shkosh në Kinë sesa në Bosnjë e Hercegovinë

Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj është takuar të premten me përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës. Në këtë takim ai ka bërë thirrje që vendet e rajonit ta trajtojnë në mënyrë të barabartë Kosovën. Ai ka thënë se më lehtë është të shkosh në Kinë sesa në Bosnjë e Hercegovinë. "Më lehtë e siguron një vizë dhe vizitë në Kinë sesa në Bosnje. Ka ardhur koha që mos të heshtim më. Vendimi ndaj mallrave të Serbisë nuk është thjesht vetëm çështje tregtare, por edhe kombëtare", ka deklaruar zëvendëskryeministri Limaj

thellojë bashkëpunimin në aspektin ekonomik. "Ne e dimë se kemi probleme të bashkëpunimit ekonomik Kosovë - Shqipëri dhe nuk jemi të kënaqur me bashkëpunimin, pasi kemi pengesa dhe telashe, mirëpo jemi në pritje të përgjigjes nga Qeveria e Tiranës për disa çështje që kemi ngritur, një prej tyre është çështja e taksës rrugore. Ne mendojmë se kjo taksë është e lartë pasi dëmton biznesin e të dy vendeve, pra pengon thellimin e bashkëpunimit. Kërkesa jonë ka qenë: qeveria shqiptare duhet ta ulë atë taksë sepse është e lartë dhe në këtë mënyrë Kosova të trajtohet ndryshe", ka deklaruar Limaj. Ai ka theksuar se për këtë kanë marrë një zotim nga Qeveria e Shqipërisë se do të dalin me një raport që do t'i përgjigjen shqetësimit të Kosovës.

Zëvendëskryeministri Limaj ka bërë me dije se po diskutojnë me Shqipërinë për zbatimin e marrëveshjeve që janë nënshkruar më herët. "Bashkëpunimi me

Shqipërinë është i mirëpritur, që biznesi ynë këtu të ketë mundësi të bëhet si në Tiranë, ashtu edhe i atyre këtu si në Prishtinë. Shpresoj se të dy vendet do ta thellojmë bashkëpunimin edhe më shumë", është shprehur Limaj.

Duke folur për vendimin e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e masës mbrojtëse për produktet e importuara nga Serbia dhe nga Bosnja dhe Hercegovina dhe reagimit ndërkombëtar për këtë vendim, si dhe rrezikut të shkeljes së marrëveshjes me CEFTA-n, zëvendëskryeministri Limaj ka thënë se Serbia në vazhdimësi e ka shkelur marrëveshjen e CEFTA-s pandërprerë. "Marrëveshja e CEFTA-s është për bashkëpunim. Kosova ka qenë e interesuar të ketë bashkëpunim me të gjitha vendet e rajonit. Ftojme vendet e rajonit të sillen me Kosovën ashtu siç kjo po sillet me to. Shpresoj se këto veprime të Serbisë dhe Bosnjës të ndalen dhe të kthehen në normalitet", ka thënë zëvendëskryeministri

Limaj.

Ai ka thënë se më lehtë është të shkosh në Kinë sesa në Bosnjë e Hercegovinë. "Më lehtë e siguron një vizë dhe vizitë në Kinë sesa në Bosnje. Ka ardhur koha që mos të heshtim më. Vendimi ndaj mallrave të Serbisë nuk është thjesht vetëm çështje tregtare, por është edhe kombëtare. Sepse sigurinë e shtetit e kemi në prioritet. Pra, shpresoj se këto veprime të Serbisë dhe Bosnjës ndaj Kosovës të ndryshojnë dhe të kthehen në normalitet", ka thënë Limaj.

Ndërkaq kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se pasi zëvendëskryeministri Fatmir Limaj është koordinatë për mbledhjen dy qeverive Kosovë - Shqipëri, e cila do të mbahet më 26 nëntor në Pejë, duhet të shkohet drejt një iniciativë të re në krijimin e një ode bilaterale me Shqipërinë. Rukiqi ka theksuar rëndësinë e përmirësimit të bilancit tregtar, ku ka përmendur rëndësinë e hapjes së tregjeve të reja për bizneset vendore.

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka mbajtur të premten një takim me përfaqësuesit e bizneseve në Prishtinë, ku është pritur nga kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi. Limaj në këtë takim është interesuar për problemet që kanë bizneset në vendin tonë dhe ka shprehur interesimin e tij për t'u ofruar atyre zgjidhje në veprimtarinë e tyre. "Ne sot jemi këtu për t'u

bashkëngjitur iniciativës së Odës së përbashkët Kosovë - Shqipëri. Qeveria e Republikës së Kosovës, sikurse qeveritë e tjera, do të vazhdojë të fuqizojë hapa të bashkëpunimit me partneritet me subjektet ekonomike, në këtë rast edhe me OEK-un që është vendi ku mbledh bizneset e Kosovës", ka thënë zëvendëskryeministri Limaj.

Ai ka shtuar se krijimi i një ode të përbashkët Kosovë - Shqipëri është një hap i rëndësishëm për dy shtetet. Limaj ka theksuar se Kosova me Shqipërinë duhet ta



Kërkohet bashkërendim për projektin ITS

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Këshilli i Sigurisë i Trafikut Rrugor (KSTRr), i udhëhequr nga ministri Pal Lekaj, ka mbajtur të premten mbledhjen e radhës në të cilën është diskutuar implementimi i projekteve për rritjen e sigurisë rrugore, me theks të veçantë gjatë natës. Anëtarët u njoftuan më gjerësisht për projektin e Sistemit Inteligent të Transportit (ITS) që do të ketë ndikim të madh në rritjen e sigurisë në trafikun rrugor. Lekaj ka theksuar se ky sistem do të ofrojë menaxhim të rrugëve sikurse në vendet evropiane. Ai ka kërkuar bashkërendim të obligimeve nga të gjitha institucionet me qëllim të funksionimit të suksesshëm të ITS-it. Më tutje, Lekaj ka treguar edhe për punën e madhe që po bëhet

drejt finalizimit të ndriçimit të autostradave, kycjeve dhe hyrjeve të qyteteve, proces ky i neglizhuar në vitet e kaluara. Ai ka njoftuar edhe për riparim të sistemit të ndriçimit në autostradën "Ibrahim Rugova" që kohë më parë ishin vjedhur pjesët e saj. Prandaj ka kërkuar nga organet e rendit bashkëpunim për siguri të aseteve infrastrukturore. Ndërsa anëtarët KSTRr-së me diskutimet e tyre vunë në pah edhe një sërë masash që duhen ndërmarrë në transportin publik të udhëtarëve, infrastrukturën rrugore që të jetë kompatible me trendët në rritje të numrit të banorëve, masave edukuese dhe disiplinimit e të gjithë atyre faktorëve që ndikojnë në rënien e sigurisë në trafikun rrugor.



Banorët e fshatit Gramqel bëhen me rrugë të re

DEÇAN, 9 NËNTOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Deçanit, Sami Cacaj, me bashkëpunëtorë dhe banorë të fshatit Gramqel, kanë qëndruar në këtë fshat ku po bëhet asfaltimi i rrugës që lidh Deçanin me Gjakovën -

Gramaçel - Firaja dhe Gramaçel - Dobrigje që përkrahin lagjet "Agaj" dhe "Gojanët". Kjo rrugë zgjidh problemin e banorëve të këtij lokaliteti, për çfarë i janë falënderues Komunës së Deçanit dhe Qeverisë Haradinaj.



Zëvendësministrat Koci e Ymeri vizitojnë Komunën e Skenderajt

SKENDERAJ, 9 NËNTOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, ka pritur të premten në takim zëvendësministrin e Zhvillimit Ekonomik, Gani Koci, dhe zëvendësministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Abdyl Ymeri, me të cilët ka diskutuar rreth bashkëpunimit dhe përkrahjes në projekte që kanë

për qëllim zhvillimin ekonomik të kësaj komune, në vazhdim të bashkëpunimit me institucionet qendrore. Gjatë këtij takimi nënkryetari Lushtaku ka njoftuar zyrtarët qeveritarë rreth angazhimit të Komunës së Skenderajt sa i përket zhvillimit ekonomik, synimet e qeverisjes lokale për të sjellë investitorë dhe për ta

investuar komunën e Skenderajt, e cila tashmë ka krijuar kushte të përshtatshme për investime. Lushtaku dhe dy zëvendësministrat u pajtuan ta vazhdojnë bashkëpunimin ndërmjet Komunës së Skenderajt dhe nivelit qendror rreth përkrahjes së projekteve në të mirë të qytetarëve.

Komuna e Malishevës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Iniciativën për Zhvillimin e Bujqësisë

MALISHEVË, 9 NËNTOR (ER) - Komuna e Malishevës dhe Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së projekteve bujqësore të realizuara nga IADK-ja në Malishevë. Në mesin e pesë komunave të Kosovës, ku IADK-ja do ta zbatojë projektin "Përfshirja ekonomike e të kthyerve përmes bujqësisë në zonat rurale dhe ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve profesionale" është përfshirë edhe Komuna e Malishevës.

Ky projekt përkrahët nga Deutsche Gesellschaft Fur International Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, i mandatuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë. Koha e realizimit është shtator 2018 - qershor 2020. Komuna e Malishevës do të krijojë të gjitha lehtësitat të parapara në marrëveshje dhe është zotuar për ta zbatuar në përpikëri marrëveshjen me IADK-në. Të dyja palët kanë përcaktuar përfaqësuesit e vet që ta mbikëqyrin zbatimin e



marrëveshjes dhe implementimin e projekteve, IADK-në e përfaqëson Arta Zhubi, projektmenaxhere, ndërsa Komunën e Malishevës, Januz Mazreku.

Marrëveshja u nënshkrua nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori ekzekutiv i IADK-së, Zenel Bunjaku.


Mblidhen asamblistët komunalë të fëmijëve në Prishtinë

PRISHTINË, 9 NËNTOR (ER) - Në bashkëpunim me organizatën "Save the Children" dhe organizatën joqeveritare "Syri i vizionit", në sallën e Kuvendit Komunal të Prishtinës është mbajtur të premten aktiviteti "Ristrukturimi i Asamblesë Komonale të fëmijëve". Asambleja e Fëmijëve - Prishtinë është themeluar më

15 qershor 2013 dhe është organ legjitim i përfaqësimit të fëmijëve në vendimmarrje në nivelin lokal dhe është ambient ku vazhdimisht promovohen liritë dhe të drejtat e fëmijëve. Asambleja e Fëmijëve - Prishtinë përbëhet nga fëmijët asamblistë, përfaqësues të shkollave të mesme të ulëta të Prishtinës.



Deri kur vetëm ne do t'i provojmë dhe pranojmë zgjidhjet e dhimbshme?!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Hienat e mashtrimit: Përfundoi edhe takimi i radhës në Bruksel midis dy sundimtarëve absolutë, Hashim Thaçi i Parë, sundimtar i Kosovës dhe Aleksandar Vuçiqi i Parë, Mbret i Serbisë, të dy të veshur alafranga (firmato), por me mentalitet dhe veprim aziatik. Këta pinjollë të shtypjes së vullnetit bëjnë përpjekje që të paraqiten si kundërshtarë që nuk duan t'ia shohin sytë njëri-tjetrit, ndërsa nëse nuk takohen për një kohë të shkurtër, i kap kriza sikur ata që janë të varur nga narkotikët, djersiten, bëhen nervozë dhe sulmojnë majtas-djathtas dhe të gjithë ata që nuk iu binden 100% e që këtë mentalitet e kanë përvetësuar nga ndërkombëtarët. Hashim Thaçi i Parë, Monarku i Kosovës, para takimit me Mbretin e Serbisë, Aleksandar Vuçiqin, deklaroi: më me dëshirë do të takohesha me një dreq, djall, shejtan se me Vuçiqin e që ky i fundit iu përgjigj në mënyrë shumë të civilizuese, duke fituar poenë politike e të cilët i ka fituar që nga fillimi. Në këto bisedime, përkundër faktit se të gjitha faktet janë në anën e Kosovës, kemi kaluar në defensivë të plotë për faktin se në këto bisedime është shkuar me duar në xhepa, pa ekip (me servilë të dëshmuar) dhe duke pranuar gjëra që nuk janë pranuar as në kohët më të vështira për Kosovën. Tash, nëse doni të bisedoni për kufijtë e vendit që është pranuar nga 114 vende (-disa çnjohje), të bisedojmë pra nëse ky që na përfaqëson është vërtet Hashim Thaçi apo është dikush tjetër që e ka marrë identitetin e Hashimit! Serbia ka interes të bisedojë jo vetëm për veriun e okupuar të Kosovës, por edhe për një centimetër të territorit të Kosovës e që nuk i takon këtij shteti, me një të kaluar të ndyrë kriminale e që, pas pastrimit përmes bisedimeve, po përpiqet të bëhet shtet demokratik, shtet me një popull të viktimizuar,

shtet që do paqe, por se kjo paqe kushton, shtet që më parë bisedon 100 vjet sesa që lufton edhe një minutë të vetëm, shtet që dëshiron ta ketë ofertën përfituese e që pastaj e vlerëson nëse do të arrijë një marrëveshje me Prishtinën (nuk e përmend Kosovën). Hashim Thaçi, i cili kishte autorizim nga Kuvendi për bisedime me Serbinë sa ishte kryeministër, ia ka bartur vetes këtë të drejtë edhe si president, pa e pyetur askënd, pa përfillur asnjë institucion, sikur të bisedojë për çështje private e jo për fatin e mbi dy milionë qytetarëve të Kosovës e që preken drejtpërdrejt dhe mbi 5 milionë shqiptarëve të tjerë e që do të preken në fazat më vonë. E lansoi një mashtrim ordiner, bashkimin e Luginës së Preshevës, pa dhënë asgjë duke manipuluar me këta të Luginës të cilëve u ka ardhur shpirti në fyt nga Serbia dhe të cilët do ta pranoni çdo zgjidhje, pavarësisht sa do të ishte e dëmshme për Kosovën dhe shqiptarët në përgjithësi. Pse Hashim Thaçi i Parë nuk kërkonte bashkimin e shqiptarëve të Maqedonisë dhe të Malit të Zi me Kosovën, kurse tash po insiston se do ta bashkojë Luginën e Preshevës, ndonëse e ka të qartë se për veriun e Kosovës mund të fitojë vetëm disa xhami të Luginës, nëse edhe ato i fiton. Me këtë mashtrim klasik dhe manipulim ka krijuar epërsi ndaj kundërshtarëve sepse gjithmonë ua shtron të njëjtën pyetje: "A nuk jeni ju për bashkimin e Luginës së Preshevës dhe pse po e kundërshtoni këtë?" E tash, edhe këta të Luginës, e që pjesa dërrmuese jetojnë dhe punojnë në Kosovë, janë bërë partizanë dhe kamikazë (të leshit) të Hashimit. Më ka ndodhur që më kanë ndaluar në rrugë luginasit e Hashimit duke m'u drejtuar me fjalët: "Pse ju zoti Shala jeni kundër bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën?", duke mos e pranuar asnjë argument politik dhe të arsyeshëm me të cilin vërtetohet manipulimi i Hashimit me ta. Situata e çuditshme është kjo!

Deklarimet pas përfundimit të takimit: Mos u besoni deklarimeve pas takimeve sepse ajo çka flitet prapa dymve të mbyllura e që aktualisht "lehtësohen" nga një përfaqësuese e BE-së, me një

background të dyshimtë familjar, pjesërisht të kriminalizuar, është në kundërshtim me ato çka deklarohet publikisht prandaj, Hashim Thaçi, pasi flet në emër tonin, ndonëse pa autorizim, nuk është i interesuar për një ekip profesional, por për eunukë intelektualë dhe të zhveshur nga interesat kombëtare dhe shtetërore, heshtjen e të cilëve e blenë me paratë tona, me paratë e buxhetit të Kosovës. Nuk ka asnjë institucion i Kosovës ku mercenarizmi është më i theksuar se në presidencë dhe ku presidentit i shtrihen para këmbëve duke e lavdëruar edhe për atë që nuk i thotë e lëre më për ato që deklarohet. Nuk mbaj mend një vend në botë ku 20 vjet pas përfundimit të luftës dhe pas pranimit të pavarësisë nga 114 vende (-çnjohjet), pranoni të diskutoni për kufijtë dhe në mënyrë idiote e ndani një qytet (Mitrovicën) për të deklaruar në mënyrë edhe më idiote se këtë e keni bërë për ta bashkuar qytetin. Apo, kur analfabetë politikë dhe të zhveshur nga çdo vlerë njerëzore, kombëtare dhe morale na vënë në gjumë duke na ofruar ëndrra me Shakirën, Lepa Brenën apo Cecën e Arkanit. Çfarë idiotizmi dhe pafytyrësie! Shakira, edhe nëse vjen, nuk vjen pa një milion euro të cilat paguhen nga buxheti i Kosovës në vend se me këto para të ndërtohet ndonjë shtëpi në veri apo të ndihmohen qytetarët e Mitrovicës dhe të Veriut e që jetojnë në kushte të mjerueshme pikërisht për fajin e matrapazëve politikë që sot e udhëheqin Mitrovicën sikur edhe ata para tyre e që janë qerasur me poste diplomatike. Na trullosin prapanicën Agim Pacolli dhe Behgjet Bahtiri me Shakirën, që e përdorin si mashtrim e që qytetarët e Mitrovicës nuk përfitojnë asgjë nga ky mashtrim. Në fund të fundit, e kemi "Shakirën" e Kosovës e cila deri në kupë të qiellit ka kënduar: "Jo nuk ndahet o Mitrovica" për një shumë simbolike parash, kryesisht të fituara në syneti, kanaxheqe, diasporë apo dasma.

Si të ndalet Hashimi: Nuk ka asgjë më lehtë se të ndalet kjo aventurë e Tom Sojerit, thjesht nuk duhet të përkrahët nga askush. Deri më tani kryeministri Haradinaj po e kundërshton vendosmërisht, kryeparla-

mentari Kadri Veseli po e kundërshton më butësisht, opozita po e kundërshton oralisht (punë gojë hesapi), kurse vetëm pionierët e PDK-së, të futur deri në fyt në detyrime ndaj Hashimit, të transformuar tani në biondina të të dy gjinive, po e përkrahin "Ataturkun" e PDK-së duke deklaruar se nuk ka njeri më të përgatitur për bisedime me Serbinë e gjë që është shumë larg të së vërtetës. Nisma i ka disa hezitime shkaku i Fatmirit që pretendon të bëhet Hashim nr. 2 në bisedime, si udhëheqës i Grupit Negociator e që, nëse miratohet në këtë formë, do të bëhet patericë e njëres këmbë të thyer të Hashimit. LDK-ja, pavarësisht potencës deklarative, në realitet është e treshur në aspektin veprues që e dëshmoi me tërheqjen e rezolutës me një arsyetim të pasinqertë, arritje e një konsensusi nacional. LDK-ja, gjithmonë kur ngulet në kunj të Hashimit apo edhe të tjerëve, e ka arsyetimin e gatshëm dhe stereotip, e bën si parti shtetformuese e që askush nuk i beson sepse individë nga kjo parti shiten e stërshiten lehtë. Kujtojeni votimin për Hashimin president, ata që e kanë sharë më së shumti, kanë votuar për të apo ia kanë bërë kuorumin. E pastaj demarkacioni e kështu me radhë. LV-ja nuk ka kapacitet ta rrezikojë Hashimin e as PSD-në. Të vetmit që mund ta kundërshtojnë këtë aventurë të Hashim Thaçit janë kryeministri Ramush Haradinaj dhe kryeparlamentari Kadri Veseli, nëse në ndërkohë nuk i lëshon kondicioni, jo fizik, por ai politik. Shoqëria civile nuk mund të bëjë asgjë sepse nuk e kanë një gojë e lëre më një bythë. Mos të them që nuk kanë fare bythë. Tash partitë më të forta në Kuvendin e Kosovës dhe që kanë perspektivë më të ndritshme në të ardhmen, Alternativa dhe AKR-ja, po mundohen mjaft, Alternativa për ta shpëtuar Kosovën (kinse), ndërsa AKR-ja për ta shkatërruar Kosovën, pa asnjë dyshim. Jam i bindur se Behgjet Pacolli e do dhe mbron Kosovën aq sa unë e dua dhe e mbroj Shumadinë dhe Kralevën. Gjithashtu, jam i bindur se e respekton Hashim Thaçin për aq sa unë e respektoj Aleksandar Vuçiqin. Dhe,

këta persona flasin dhe marrin vendime për Kosovën?! Zot, o Zot!

Hashim Thaçi duhet të ndalet dhe do të ndalet. Jam i sigurt se kur të bindet se nuk mund ta realizojë flirtin me Vuçiqin, do të bëhet kundërshtar i madh i tij sikur që Enver Hoxhaj, nga pozitë krejtësisht "patriotike" po i kundërshton mallrat nga Serbia!

Nuk duhet të mbesim peng të një Kurci, Makroi, një karriere në përfundim si Mogerini e cila përpiqet të mbijetojë dhe ringjallet duke përligjur dhurata të tokave të Kosovës për Serbinë dhe burokratëve të tjerë të Evropës. Natyrisht se nuk mund dhe nuk duhet të presim mirëkuptim dhe përkrahje për territorin e Kosovës nga të huajt nëse ankandin për falje e hapim ne, përkatësisht ai që nuk na përfaqëson, Hashim Thaçi.

Begja, me llaskuçet përreth në çdo çnjohje që e bënte publike Serbia, deklaronte se është rrenë dhe mashtrim derisa ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, këto çnjohje i mori si të vërteta.

Ndërkombëtarët na konsiderojnë leshko dhe gjysmë të marrë që servilizmin e konsiderojmë si virtut andaj, ndonëse i kemi plotësuar kushtet teknike për liberalizim të vizave, sigurisht më shumë se vendet e rajonit që kanë përfitur, nën rrogos na shantazhojnë duke e ndërlikuar këtë proces me procese politike, përkatësisht, me lëshim të brekëve para Serbisë dhe disa karrieristëve dhe burokratëve ndërkombëtarë, përkrahës tradicionalë të Serbisë.

Është kohë e fundit që idetë për korrigjim të kufijve e që kanë dalë nga bytha e propozuesve, të kthehen në burimin e këtyre ideve jonormale. Ndryshe, na presin shumë probleme neve që do të jetojmë këtu, kurse për ata që e propozuan dhe përkrahin këto çmenduri, Kosova do të bëhet "Tokë e ndaluar".

E shohim shumë shpejt sepse Mogerini po ngutet, Hashimi po ngutet dhe Vuçiqi po ngutet! Dikush, pashmangshëm do ta pësojë, uroj të mos jetë Kosova dhe qytetarët e saj, kurse për ata që i shoqërojnë këta ose i përkrahin nuk do të ndiej as dhimbjen më të vogël pas pësimin dhe fundit të keq që do ta kenë, pa asnjë dyshim!


Poezi me vlera të larta artistike

(Duke lexuar tufën e poezive "Porta e këngës" të Avdush Canajt)

Jonuz FETAHAJ

Vëllimi më i ri me poezi "Porta e këngës" të poetit Avdush Canaj pa dyshim se sjell një ardhje të mirëfilltë të poezisë për më të vegjlit, pra atyre që u dedikohet më me përkushtim, sepse përmes verbit poetik gjithsesi autor është munduar që të njëjtësohet me gjithë botën imagjinative të fëmijës, i cili, duke eksploruar gjithë brendësinë e botës filozofike e psikologjike, është munduar që sa më thellësisht të hyjë nëpër gjallimin e gjetjeve që i vëren rreth vetes dhe jo vetëm ato, por edhe të një hyrje në të parë në mendësinë reale për ta kërkuar herë-herë edhe arealen, por që gjithnjë duke provuar të skalit mendimin, duke e shtruar fjalën dhe metaforën, simbolin e krahasimin, fenomenet e natyrës dhe gjithë kozmosin e shtjelluar brenda margjinave të cikleve të poezive që, dorën në zemër, secila ka peshën dhe specifikën e vet dhe që të gjitha nëse shkrihen në një tërësi, por për këtë kërkohet vëmendje dhe dashuri për të lexuar nga poezia hapëse e vëllimit "Lulja ma jep dorën" e deri te poezia mbyllëse "Aty më keni", do të gjezdisni nëpër vargje e strofa që të marrin e s'të lëshojnë, të mbajnë si një peng i mirë për ta shoqëruar secilin varg, secilën strofë, secilën poezi, po se jo edhe secilin cikël, i cili lidhet e ndërldhet përmbajtësisht me vazhdimësinë e këngëtimit dhe të rrëfimit që nga fillimi e deri në fund. Pra, duke u nisur nga cikli: "Meqë ra fjala", "Mos bën shaka te yjet", "Kam parë hatanë", "Tregimi i gjyshit", "Lulet pyesin për ty" dhe "Degë me ylber", krijojnë një tërësi organike gjithë anatomisë së vargjeve që autori me përkushtim më të madh ka arritur t'i sendërtojë dhe degëzojë nga faqja në faqe, nga cikli në cikël. Dhe, jo vetëm kaq.

Avdush Canaj në këtë vëllim poetik që mund të lexohet edhe si poemë, por edhe si recital, po edhe si një roman që ka ngjarjen dhe porosinë e vet, gjithnjë duke marrë imazhe nga jeta, nga përditshmëria, por që duke u dhënë ngjyrë fjalës, lojës, rrë-



fimit, këngës dhe zanoreve e bashkëtingëlloreve të çdo fjale, sepse kur vargënon autori, përherë ka pranë vetës botën që e rrethon, e ndjen, e prek, e përjeton, e vizaton me fjalë, e kolorizon me krahasime e simbole, me metafora e porosi që lexuesin e bëjnë për vete, e bëjnë gjithnjë të mos i ndahet deri në pikën e fundit, pra kur përfundon e mbyllet brenda kopertinave libri "Porta e këngës". Por edhe atëherë, gjithsesi, duke mos dashur të ngopet, pra duke ndjerë edhe me uri e etje, sërish hyn nga e para, fillimi dhe nuk e bjerr kohën, por gjen edhe atë fshtësinë e ndryrë nëpër vargje, qoftë atëherë kur futën në fjalë figuracioni apo edhe niveli ideo-estetik që e ngritin në pedestal piramidën e kuptimit të vargut dhe zbërthimin e lojës

në art. Të themi, gjithashtu, se Avdush Canaj nuk "ngutet" kur shkruan, por me urtësinë e vet, me angazhimin që bën për të shkruar një varg a strofë, arrin të mishërohet me botën e të vegjëlve, veçmas të një moshe të lexuesve që janë të pasionuar për ta thithur nektarin e mirëfilltë të këngëtimit dhe jehun e tij do ta shndërrojë në një muzikë që nuk të bezdisë, por që të shoqëron në simfoninë e fjalës dhe këngës për një kohë të gjatë. Vetëm në këtë kohë dhe mënyrë, nëse lexohet ky vëllim do të zbërthehet tërë ajo që është akumuluar si rrokje e si rrëfim, si ngjarje e si vaki, si gjetje e si pjellë imagjinative që të pasuron e të josh për një kohë të gjatë, madje të bëhet edhe pjesë e pandarë e bibliotekës personale që do të ruhet me xhelozzi për një kohë të gjatë.

KOSOVË ME KËMISHË TË KUQE QË 2000 VJET

*Kosovë e bimë në Tokë
Me këmishë t'kuqe që 2000 vjet
Me plis t'bardhë mbi kokë
Kosovë piramidë në det...*

*Guri me gurin të betuar në shkëmb
Me duart e Dritës natën e kanë shkund
Thikat e tmerrit po thyhen ndër dhemb...
Gjenocidin e zi Drenica do ta mund*

*Guri me gurin t'përqaftuar në fitore
Në Kala janë murosuar jeta me jetë...
Kosova i bënë ballë dhunës mizore
Malisheva dëshmitare e shekullit 20-të*


*Llapi... Zhuri...Baladë e kuqe e shkruar
Ujem duke marrur mikrobi i gjenocidit
Në kisha e xhamia dhuna ka kafshuar...
Si sfina e gjallë e Jack Rabinit...*

*Kosova e dhunuar mordën do t'a mund
Me këngën e Dritës terrin do t'a shkund
Kosova heroike me plagë në ballë
Kosova historike, trojë e gjallë...*

*Lisa me pisha një rrënjë në një shkëmb
Sakicës i qëndrojnë me tyt ndër dhembë
Kroi i Kosovës gjakshëm gurgullon...
Retë edhe dielli shpesh i përjeton...*

*Kosovë historike t'a patën lakmi -
Gjeanologjinë... Historinë... Dashurinë...
Hamleti Kleopatra Cezari Cari Murati
Antonio Garibaldi Ofelia... Çelebia
Bizmarku... Riçardi i tretë...
Edhe shiu... edhe retë...*

*Kosovë me këmishë të kuqe që 2000 vjet
Kosovë Kala në det...*



Behram HOTI

NESËR

*Nesër do të ndryshojë bota,
Do të tretën ëndrrat, idealet...
Këngët do të këndohen ndryshe,
Dhe lulet do ta ndërrojnë ngjyrën.*

*Nesër do të jetë më ftohtë se "sonte",
Nuk do të ngrohë dielli i mëngjesit,
Në sytë e njerëzve do të bjerë shi, dëborë,
As Drini nuk do ta shuante etjen!*

*Nesër do të ndryshojnë njerëzit,
Do të shikojnë me gjysumsyri,
Fjalët do t'i qesin në peshojë,
Do të tretën të gjitha kujtimet.*

*Nesër nuk do të lexohet poezia,
Vargjet do të grimcohen, digjen,
Do të ndryshojnë stinët, vitet...
Lumi nuk do të rrjedhë si gjithmonë.*

*Nesër njerëzit nuk do të jenë si "Sonte",
Të ngrohtë si rrezet pranverore,
Do ta ndryshojnë pamjen, veshjet, ecjet...
Ani, veç njerëz le të mbeten pashë Zotin!*

*(Poezi e Ismet Rashitit (meteor) që
mori vendin e parë në konkursin letrar
të vitit 2005 në revistën "Zëri i largët")*



Ismet RASHITI

E jashtëzakonshme

Njihuni me kërpudhën bionike që prodhon elektricitet

Gjetja e mënyrave të pastra për të gjeneruar energji është prioritet i shkencëtarëve të etur, për ta ulur shfrytëzimin e lëndëve djegëse fosile. Tani një ekip hulumtuesish amerikanë thonë se ata kanë gjetur një mënyrë për të bërë energji miqësore me mjedisin, duke përdorur kërpudha bionike të mbuluara me baktere.




FOTO E DITES



Një pamje ajrore e anijeve në Liqenin Marmara, ku nivelet e ujit kanë rënë pas temperaturave të larta gjatë verës. / AA/

E rrallë

Mrekulli në Kinë, zgjohet nga koma pas 12 vjetësh

Një burrë doli nga koma pas 12 vjetësh dhe përjetoj emocione të forta kur hapi sytë dhe pa personin që i rrinte te koka. E ëma 75-vjeçare, prej 12 vjetësh ishte kujdesur për të çdo ditë dhe natë. E moshuara nuk i përbajti lotët në



momentin që pa të birin të përmendej, pikërisht kur shpresat thuajse ishin shuar.

BARSOLETA E DITËS



- Shoqet:**
- Ishe e sëmurë?
 - Jo. Pse pyet?!
 - Pashë doktorin që hynte e dilte shpesh nga dera juaj.
 - Pse në shtëpinë tënde, që hynë e dalin ushtarë, luftë po bëhet?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee




Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

| | | | | | |
|---|--|--|--|--|---|
|  <p>DASHI Sot do ta ndjeni veten të përfshirë në një çështje që ju ka lënduar pa masë. Shumë persona nuk do ta kuptojnë sjelljen tuaj dhe do të kërkojnë shpjegime.</p> |  <p>DEMI Po ju tërheq fillimi i ditës dhe po ndiheni dhe ju më të karikuar se zakonisht. Është koha për të ndërmarrë aktivitete të reja dhe udhëtime të shkurtra.</p> |  <p>BINJAKËT Sot do të jetë një ditë shpenzimesh për ju. Do të shikoni që lekët do t'ju fluturojnë nga xhepat edhe për gjëra që mbase nuk i keni shumë të nevojshme.</p> |  <p>GAFORRJA Partneri ju ka bërë një surprizë duke ju dhuruar një udhëtim të shkurtër. Do të lumturoheni pa fund dhe po bëni gati valixhet.</p> |  <p>LUANI Shumë gjëra dhe projekte po diskutohen në tavolinë sot, por nuk keni asnjë gjë konkrete mbi të cilën doni të punoni.</p> |  <p>VIRGJËRESHA Për momentin asnjë person i veçantë nuk ka zgjuar tek ju zjarrin e pasionit. Me ndryshimet e fundit prisni të ndryshojë edhe gjendja juaj sentimentale.</p> |
|  <p>PESHORJA Në fushën profesionale sot do të keni një ndihmë të madhe nga kolegët, pa bashkëpunimin e të cilëve nuk mund të realizoni asgjë. Tregohuni mirënjohës.</p> |  <p>AKREPI Sot ndiheni të dhunuar psikologjikisht në ambientin e punës dhe reagimi do të jetë mjaft i fortë. Do të përfshihen edhe persona të tjerë, përveç eprorëve tuaj.</p> |  <p>SHIGJETARI Sot do të shpërndani dashuri pa fund në ambientin tuaj familjar. Partnerët dhe fëmijët janë të vetmit që sot do të marrin të gjithë vëmendjen tuaj.</p> |  <p>BRICJAPI Nuk do të jetë një ditë aspak e qetë kjo e sotmja dhe të gjithë e kërkojnë fajin te ju. Një problem do ta tërheqë vëmendjen tuaj me shumë se të tjerët.</p> |  <p>UJORI Keni kurajon t'i mbron argumentet tuaja dhe kjo ju ka bërë të rreshtoheni nga ana e personave të drejtë. Kompromiset mund t'i bëni shumë rrallë.</p> |  <p>PESHQIT Sot dëshironi të merreni vetëm me aktivitete që nuk kanë nevojë për përfshirje shumë të madhe. Dita do të shkojë mirë në çdo aspekt.</p> |

Jenniferi dhe Beni janë zyrtarisht të shkurorëzuar



Ben Affleku dhe Jennifer Garneru tani janë zyrtarisht beqarë, meqë një gjykatës privat e ka nënshkruar shkurorëzimin e tyre, shkruan "TMZ". Javën e kaluar ish-çifti paraqiti dokumentet përfundimtare për të shkuar tutje me divorcin e tyre

dhe të mërkurën kjo u bë zyrtare. Kushtet e marrëveshjes përfshijnë kujdestarinë e përbashkët të tre fëmijëve të tyre dhe janë pajtuar edhe të marrin pjesë në seanca terapeutike të bashkëprindërimit një herë në muaj për të paktën gjashtë muaj.

Khloe Kardashian i jep fund lidhjes me Tristan Thompsonin



Bukuroshja e familjes Kardashian, Khloe, është e njohur për krizat që kaloi me babanë e vajzës së saj, Tristan Thompson, pasi ky i fundit e kishte tradhtuar. Ajo tha se e fali për të

nisur gjithçka nga e para. Siç duket, kjo gjë nuk funksionoi. Basketbollisti i njohur kohët e fundit u përfol edhe për një tradhti të dytë, por këtë herë Khloe ka vendosur që mos të falë duke e vazhduar jetën prej beqareje.




Ariana Grande është përzgjedhur "Gruaja e vitit në muzikë"

Këngëtarja Grande pritet ta marrë çmimin "Gruaja e vitit në muzikë" më 6 dhjetor të këtij viti nga Billboard. Kjo mbrëmje do të mbahet në Nju Jork dhe është edicioni i 13 i organizimit të Billboard. Grande

ka pasur edhe një arritje tjetër kur hyri në top 40 me këngët "No tears left to cry", "Breathin" dhe "God is a woman". Me çmimin "Gruaja e vitit" janë nderuar edhe Taylor Swift, Lady Gaga, Madonna e Selena Gomez.

Adriana Lima e lë "Victoria's Secret" pas 20 vjetësh



Të enjten Adriana Lima ka njoftuar se po e lë "Victoria's Secret" pas gati 20 vjetësh sa ishte modele e markës për të brendshme. "E dashur Victoria, faleminderit që më tregove botën, duke ndarë sekretet dhe, më e

rëndësishmja jo vetëm duke më dhënë krahë, por duke më mësuar të fluturoja. Dhe të gjithë zemra për tifozët më të mirë në botë!", ka shkruar modeluesja në rrjetin social "Instagram".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| | | | | | | |
|-------------------|------------------|---|-----------------------|---|----------------------------|---|
| PROGNOZA SPORTIVE | GIRONA - LEGANES | 1 | HOFFENHEIM - AUGSBURG | 1 | LINCOLN CITY - NORTHAMPTON | 1 |
|-------------------|------------------|---|-----------------------|---|----------------------------|---|

Llapi dhe Drita, veç për fitore në 'Zahir Pajaziti'

Deri i javës së pesëmbëdhjetë në elitë zhvillohet sot (e shtunë) në stadiumin "Zahir Pajaziti" në mes të Llapit dhe Dritës. Edon Zeqiri ka paralajmëruar se fitorja është alternativa e vetme e vendësve në këtë ndeshje por, sipas mbrojtësit Fidan Gërbeshi, për fitore në Podujevë udhëton edhe skuadra nga Gjilani



ndeshje e bukur për publikun deri në fund. Ne udhëtojmë në Podujevë për pikët maksimale, për çfarë të gjithë futbollistët do ta japin maksimumin", ka thënë Gërbeshi. Krahas ndeshjes Llapi -

Drita, sot (e shtunë) nga ora 15:00 zhvillohet edhe ndeshja tjetër e javës së 15-të; takohen Liria dhe Flamurtari. Katër ndeshjet e tjera të kësaj xhironje zhvillohen të dielën nga ora 13:30.

IPKO Superliga

Të shtunën takohen:
Liria - Flamurtari
Llapi - Drita

Të dielën takohen:
Gjilani - Drenica
Trepça '89 - KEK-u
Prishtina - Ballkani
Feronikeli - Ferizaj
(Të gjitha ndeshjet fillojnë në orën 13:30)

LIGA E PARË

Të shtunën takohen:
2 Korriku - Drenasi
Trepça - Arbëria
Istogu - Onix

Të dielën takohen:
Vllaznia - Fushë-Kosova
Vitia - Kika
Besa - Vëllaznimi
Bashkimi (K) - Ramiz Sadiku
Vuhstrria - Dukagjini

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 NËNTOR - KF Llapi synon tri pikët e plota ndaj Dritës në ndeshjen derbi të javës së 15-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Futbollisti Edon Zeqiri ka thënë të premten për "Epokën e re" se skuadra e Llapit dëshiron fitore në derbi, pasi çdo rezultat tjetër do të linte këtë skuadër shumë pas Prishtinës dhe Llapit në renditjen tabelore. "Gjatë gjithë javës jemi përgatitur për këtë ndeshje derbi dhe ne kemi respekt për skuadrën e Dritës që është kampione aktuale. Megjithatë, në këtë ndeshje, me

mbështetjen e shikuesve, 'Legjendave', synojmë maksimumin, përndryshe do të mbesin shumë pas dy skuadrave tjera të para në tabelë. Atmosfera në klub është e mirë, kurse për këtë ndeshje mungojnë Januzi, Begolli dhe Hajdini", ka thënë Zeqiri. Aktualisht Llapi pozicionohet në pozitën e tretë me 26 pikë, kurse katër pikë më pak ka skuadra e Dritës që pozicionohet e katërta.

Për ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Zahir Pajaziti" ka folur edhe mbrojtësi i Dritës, Fidan Gërbeshi. "Ne dhe Llapi jemi dy nga pretendentët për titull të kampionit, prandaj do të jetë një

Dy të arta dhe një e argjendtë

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Dy medalje të arta dhe një të argjendtë sporti i xhudos ia ka sjellë Kosovës nga Grand Prix në Tashkent të Uzbekistanit. Xhudistja Distria Krasniqi e ka fituar medaljen e artë, pasi në finale arriti fitore ndaj Eva Csernovski të Hungarisë. Distria e ka mundur hungarezën me ippon pasi më parë hungarezja shkaktoi tri ndërhyrje të parregullta derisa Distria kishte edhe një vazari. Medaljen e artë e ka fituar edhe Majlinda Kelmendi, e cila në finale e mposhti Evelyne Tschopp me ippon. Nora Gjakova ka dështuar t'ia sigurojë medaljen e tretë të artë Kosovës në Uzbekistan, pasi është mposhtur në finale nga gjermania Theresa Stoll me ippon.



Pas suksesit që arritën xhudistet e Kosovës, trajneri Driton Kuka ka ironizuar me shtetin e Uzbekistanit, duke thënë se i njohu vlerat e Kosovës edhe përkundër faktit që nuk e njeh si

shtet. "Tri finaliste, dy të arta për Kosovën dhe një e argjendtë! Kryeqyteti i një shteti që ende s'e njeh Kosovën goxha mirë u njoftua me vlerat tona sot", ka shkruar Kuka në "Facebook".

Challandesi publikon listën, risi Muriqi dhe Kryeziu

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës, Bernard Challandes, ka publikuar listën e futbollistëve që do t'i grumbullojë për dy ndeshjet e fundit të kuadër të Grupit 3 të Ligës D në Ligën e Kombeve kundër Maltës si mysafirë, më 17 nëntor dhe kundër Azerbajxhanit, më 20 nëntor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Për

herë të parë janë ftuar portieri Arijanet Muriqi dhe mesfushori Mirlind Kryeziu. Grumbullimi i futbollistëve bëhet të hënën në hotel "Emerald", derisa stërvitja e parë mbahet të martën. Lista e futbollistëve: Ujkani, Muriqi, Bekaj, Rrahmani, Aliti, Vojvoda, Paqarada, Kololli, M. Kryeziu, Xhemajli, H. Kryeziu, Shala, Voca, Halimi, Berisha, Zeneli, Rashica.

Ylli - Bashkimi, derbi i javës në basketboll

PRIZREN, 9 NËNTOR - Të shtunën, me përballjen në mes të Rahovecit dhe Boreas që do të luhet me fillim nga ora 17:00 në palestrën e sportit "Shani Nushi" në Gjakovë, do të nisë xhironja e tetë në Superligën e Kosovës në basketboll. Rahoveci në shtatë xhirot e para ka regjistruar 6

fitore e 1 humbje, kurse Borea ka bilanc prej 2 fitoresh e 5 humbje. Ndërkaq po të shtunën në program është dueli në mes të Trepçës dhe Z Mobile Prishtinës. Ky takim do të luhet në orën 19:00 në palestrën e sportit "Minatori" në Mitrovicë. Trepça në shtatë xhiro ka realizuar 2

fitore e 5 humbje, kurse Z Mobile Prishtina ka bilanc prej 6 ndeshjesh e po aq fitore. Të dielën në program janë dy ndeshje të tjera, ku në orën 17:00 në palestrën e sportit "13 Qershori" në Suharekë Golden Eagle Ylli e pret Bashkimin, kurse dy orë më vonë në palestrën e

sportit "Sezai Surroi", Ponte Prizreni e pret Lipjanin. Golden Eagle Ylli ka bilanc prej 4 fitoresh e 3 humbjes, kurse Bashkimi ka regjistruar 3 fitore e 4 humbje. Ponte Prizreni në shtatë xhiro ka shënuar 3 fitore e 3 humbje, kurse Lipjani ka realizuar 1 fitore e 6 humbje.



Ismajli, pasi la Kosovën për Shqipërinë: Jemi një komb!

Tiranë, 9 nëntor - Ish-kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës U21, Ardian Ismajli, i braktisi "Dardanët" për t'iu bashkuar Shqipërisë. Në një intervistë për mediat kroate pas ftesës, ai ka dhënë arsyet se pse zgjodhi ta përfaqësojë kombëtaren kuqezi. "Menjëherë pas telefonatës së Panuccit vendosa të luaj për Shqipërinë në të

ardhmen, por nuk doja t'i lija shokët te Kosova U21 deri në përfundim të kualifikueseve. Isha kapiteni dhe lojtari më i mirë, ndaj nuk do të kishte qenë vendim i mirë t'i lija ata në baltë", ka deklaruar ai. Ismajli, i cili ka luajtur pak me Hajdukun e Splitit gjatë kësaj periudhe, e di që do ta ketë shumë të vështirë të fitojë një

vend në formacion te Shqipëria, megjithatë ai beson te aftësitë e tij dhe është i gatshëm për të luajtur që në sfidën e radhës ndaj Skocisë. "Ne jemi një komb. Shpresoj që së shpejti të bashkohemi në një shtet, por kemi ekipe të ndryshme. Shqipëria është më e mirë dhe më ofron mua më shumë mundësi për t'u promovuar. Veç

të tjerave, unë kam luajtur për Kosovën U21. Ky ishte motivi kryesor për vendimin e marrë, që kishte edhe mbështetjen e prindërve të mi. Disa gazetarë dhe tifozë më kritikojnë mua, duke pretenduar se nuk do të ketë vend për mua te kombëtarja shqiptare për shkak se nuk kam luajtur shumë te Hajduku. Por unë jam i bindur dhe i sigurt



për vendimin që kam marrë. Unë jam gati të luaj që kundër Skocisë në Ligën e Kombeve", ka deklaruar Ismajli.

Në 'Karagaçi' përballen të pamposhturit

PEJË, 9 NËNTOR - Sot (e shtunë) luhet derbi i stinorit në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Në kuadër të javës së shtatë kampionale, nga ora 19:00 në palestrën "Karagaçi" në Pejë përballë do të jenë Besa Famgas e Kastrioti. Bëhet fjalë për dy skuadrat lidere, skuadrat e vetme që i kanë fituar të gjitha ndeshjet e deritashme. Për shkak të goldlimit më të mirë pas javës së gjashtë Kastrioti është në vend të parë, ndërsa Besa Famgas është e dyta. Të dy skuadrat i kanë nga 12 pikë dhe pritet të luftojnë për trofe këtë edicion së bashku me ndonjë skuadër tjetër. Te Besa e Kastrioti janë të grumbulluar shumë prej lojtarëve më të mirë të vendit dhe për këtë pritet një ndeshje shumë e fortë e, po ashtu, shumë cilësore. Pritet që edhe interesimi të jetë në nivel dhe që në palestër të jenë të pranishëm adhurues të hendbollit jo vetëm nga Peja dhe Ferizaj, por edhe nga qytete të tjera të vendit.



Besa është kampione në fuqi, ndërsa ka kaluar edhe një kundërshtar evropian këtë edicion. Kastrioti, po ashtu, ka kaluar kundërshtarë evropianë dhe më vonë këtë muaj luan sërish ndeshje evropiane. Klubi me nam ferizajas është organizuar fuqishëm për këtë edicion dhe synon ta ndërpresë dominimin e Besës. Por te Besa janë të vendosur të fitojnë trofe dhe kështu

pritet një ndeshje cilësore që besohet se do të jetë reklamë e mirë për hendbollin e Kosovës në përgjithësi. Në hije të derbit të stinorit luhen edhe ndeshjet e tjera të javës së shtatë. Të shtunën takohen: Zhegra - Samadrexha (18:00), kurse të dielën takohen Vëllaznimi - Trepça (17:00), Vushtrria - Prishtina (17:00) dhe Drenica - Drita (14:00).

Milwaukee, 'leksion' kampioneve të Golden States

OAKLAND, 9 NËNTOR - Katër takime të luajtura në NBA, por surprizat nuk kanë munguar. Milwaukee, skuadra që këtë sezon ka befasuar me paraqitjet e saj, ka triumfuar 134-111 ndaj Golden States, në fushën e kësaj të fundit. Një nga ndeshjet më të dobëta të kampioneve të Warriorsit vitet e fundit, edhe pse në fushë ishin të gjithë lojtarët "big". Thompsoni me 24 pikë ishte shënuesi më i mirë për vendësit, ndërsa Duranti e mbylli me 17 pikë e Curry me 10, por që s'mjaftuan. Për Milwaukee u daluan Bledsoe me 26 pikë, Antetokounmpo me 24 e Brogdon me 20 pikë, ndërkohë që 45 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. Oklahoma duket se e ka kaluar ngërçin e fillimit të sezonit, duke mundur 98-80 Houstonin, një përballje mes dy ekipesh pretendente për titull në perëndim. Ky është suksesi i shtatë radhazi për Thunderin, që fitoi edhe pa Westbrookun, ndërkohë që u dal-



lua George me 20 pikë e 11 rebounde. Fiton edhe Bostoni, që

mundi 116-109 Phoenixin, një fitore me përmbysjen e miqve në kohën shtesë. Phoenixi udhëhoqi deri në 22 pikë (Bookeri 38 pikë), por nuk arriti të triumfojë, ndërkohë që Celticsi përmbysi shifrat në fund falë 39 pikëve të Irvingut. Portlandi, falë 25 pikëve të Lillardit, mundi 116-105 Clippersat.

Rezultatet

| | |
|--------------------------|---------|
| Oklahoma - Houston | 98-80 |
| Phoenix - Boston | 109-116 |
| Portland - Clippers | 116-105 |
| Golden State - Milwaukee | 111-134 |

SHKURT

Mentor Mejzini i bashkohet Liburnit

Pas Narcis Alibegut dhe Kemajl Gashit, Mentor Mejzini është përforcimi i radhës për skuadrën e Liburnit nga Gjakova. Mejzini deri tash ishte pjesë e skuadrës së Feniksit nga Drenasi, por pas shuarjes së këtij klubi ai vendosi t'i bashkohet klubit gjakovar. Vlen të ceket se Mejzini ka qenë pjesë e Liburnit në "Main Round" të UEFA Futsal Cup 2017/18 në Zagreb të Kroacisë. "Lojtar me statistika të shkëlqyera dhe golashënues i madh. Superlojtarët si Mentori gjithmonë i mirëpresim. Liburni dita-ditës po bëhet më i fuqishëm me një ekip të përbërë nga ajka e lojtarëve të futsallit", thuhet në njoftimin e Liburnit. Ndeshjen e radhës skuadra kuqezi nga Gjakova e zhvillon ndaj FC Prizrenit të dielën nga ora 21:00 në palestrën e sportve "Sezai Surroi".

Loret Sadiku refuzon Shqipërinë

Futbollisti Loret Sadiku nuk do t'i bashkohet Kombëtares së Shqipërisë, ani pse trajneri Christian Panucci e ka ftuar për ndeshjen e Ligës së Kombeve ndaj Skocisë dhe miqësoren ndaj Uellsit. Trajneri italian i kuqezinjve, Christian Panucci, në vend të Sadikut e ka ftuar mesfushorin Ergys Kaçe.

Shaqiri mund të largohet nga Liverpooi

Futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri mund të largohet në muajin janar nga Liverpooi. Mosaktivizimi si titullar nga trajneri Jurgen Klopp e ka detyruar Shaqirin të mendojë për të ardhmen. Mediet në ishull bëjnë me dije se Galatasaray është i interesuar për transferimin e tij. 27-vjeçari iu bashkua Liverpooit gjatë verës, kurse kontrata e tij me këtë klub është deri në 2023-n.

Mourinho "kërcënon" Cityn

Trajneri Jose Mourinho ka thënë se të dielën Manchester City nuk do ta ketë të lehtë ndaj Manchester Unitedit. "Nuk mendoj se ndeshja e së dielës është e veçantë për atë që ndodhi sezonin e kaluar. Ne luajmë dy ndeshje të vështira në udhëtim kundër Chelsea dhe Juventusit. Ne kemi arritur rezultate të mira në këto dy ndeshje. Ndeshja kundër Manchester City është shumë e vështirë kundër një ekipi të vështirë, por nuk e besoj se do të jetë një ndeshje e lehtë edhe për ta", ka thënë Mourinho.

Murray: Ishte një vit i vështirë, gjithçka nis nga e para

